

Tirane me 10/08/2023

**STATUT
I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ e-Partner Solution ”**

Në bazë e në zbatim të ligjit

- Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregëtare” më poshtë referohet si “Ligji Për Shoqeritë”,
- Nr.7512 date 10.08.1991 “ Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private , nismës së lirë dhe të veprimtarisë private dhe privatizimit”;
- Nr.9723 , datë 03.05.2007 “Për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit”;

veprimtaria e shoqërisë
“ e-Partner Solution ” sh.p.k.

do të organizohet dhe do të drejtohet sipas këtij Statuti të trajtuar në të njëjtën dokument me Aktin e Themelimit.

**PJESA E PARE
DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

**Neni 1
Ortaku**

1.1 Ortakët e shoqerise janë :

1. **ELTON SOTA** , i lindur më 08.01.1981,i identifikuar me karte identiteti me numër personal I10108015H, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, i cili do te zoteroje 1 kuote e cila perfaqeson 67% të kapitalit të shoqërisë.
2. **ZAMIRA RUBJEKA** , e lindur më 17.07.1972 ,e identifikuar me pasaporte me numër 533567005, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, e cila do te zoteroje 1 kuote e cila perfaqeson 33% të kapitalit të shoqërisë..

**Neni 2
Emri**

Emri i shoqërisë është “ e-Partner Solution ” sh.p.k, (më poshtë referuar si “Shoqëria”).



Neni 3

Selia e Shoqerisë

- 3.1 Selia e Shoqerisë është në adresen: Rruga Tish Daija , Kompleksi Kika 2 , Godina 11 Shkalla 1 Kati 6 , Zona Kadastrale 8260, Tirane 1001
- 3.2 Shoqeria mund te hapë degë, zyra përfaqësimi brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 4

Forma ligjore

- 4.1. Shoqeria është shoqeri shqiptare dhe është krijuar si shoqeri me përgjegjësi të kufizuar.

Neni 5

Kohëzgjatja

- 5.1. Shoqeria do te ushtrojë aktivitetin e saj tregtar per një periudhe te pacaktuar (pakufizuar).

Neni 6

Objekti i aktivitetit

Objekti i veprimitarisë së shoqerisë “ e-Partner Solution “shpk konsiston në veprimtari si me poshte :

6.1 Dizajnimi dhe mirembajtja e web-faqeve, software-ve, shitje online, platformat e shitjeve online, marketingu online dhe studime te tregut. Marrja persiper dhe kryerja e cdo biznesi reklamues, prodhimi i materialeve reklamuese dhe ofrimi i sherbimeve te marredhenieve per publikun, sponsorizimet, sherbime te komunikimit ne per gjithesi. Ofrim sherbim produksion foto, video, audio.

Përpunimin dhe analiza e të dhënave për bizneset dhe organizatat, edhe duke përdorur burimet njerëzore të të tretëve, konsulence dhe asistencë lidhur me drejtimin dhe organizimin për sa i përket marketingut, prodhimit, tregimit, administrimit të financave, me funksionet e qeverisjes së korporatave, çështjet e korporatave, planifikimin fiskal, organizimin e sistemeve si dhe ato të informatikës së aplikuar, puna kërkimore, përzgjedhja dhe trajnimi i personelit, Ofrimi i ndihmës, këshillave, koordinimit dhe kontrollit për investime të mundshme në Shqipëri dhe jashtë vendit, në emër të klientëve, hulumtimi i partnereve financiare, industrial ose tregtar në emër të klientëve.

Dhënien me qira të hapësirave të pajisura për përdorim zyrë, ofrimin e shërbimeve për bizneset dhe profesionistet që kanë të bëjnë me përdorimin e



zyrave dhe dhomave të mbledhjeve të pajisura me të gjitha strukturat logjistike, dhe organizative - administrative, sekretari të plotë të shërbimeve, si dhe përdorimi i strukturave të komunikimit dhe informacionit.

Agjensi organizim evene. Operator Turistik. Organizim guida turistike kulturor dhe biznesi, turizem mjekesor dentar dhe estetik.

Import eksport te mallrave industriale e ushqimore, prodhime bujqesore e blegtorale, suplemente dhe pajisje sportive. Tregetim i mallrave dhe produkteve made in Albania dhe promovimi ne tregjet e huaja. Mallra dhe produkte bimore, medicinale, artizanale dhe tredicionale.

Aktivitet ne agroturizem, hoteleri, bar- restorant, dhe furnizimin me produkte dhe pije si aktivitet tregtar. Në ushtrimin e këtyre aktivitetave kompania mund të përdorë dege, zyra, agjenci dhe depo në të gjithë vendin si edhe jashtë vendit.

6.2. Shoqeria mund te kryeje edhe aktivitete te tjera shtese, me qellim permbushjen e veprimtarise te saj kryesore ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

PJESA II **KAPITALI I SHOQËRISE DHE KUOTAT**

Neni 7 **Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali i shoqërisë është 100,000 (njeqind mijë) Lek i marrë përsipër dhe i nënshkruar nga ortakët.

Kapitali themeltar është i ndarë në 2 (dy) kuota me vlerë nominale 100,000 (njeqind mijë) lekë të cilat zotërohen nga ortakët si me poshtë :

Ortaku	Kuotat e Nenshkruara	Vlera ne Leke	Perqindja (%)
1. ELTON SOTA	1	67,000	67
2. ZAMIRA RUBJEKA	1	33,000	33
Total	2	100,000	100

Kapitali themeltar është vetëm në monedhën vendase, lek.

III. STRUKTURA DREJTUESE TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKEVE



Neni 8
Përgjegjësia e kufizuar

8.1. Ortakët janë përgjegjës deri në vlerën e pjesës së tyre në kapitalin e Shoqërisë. Shoqëria është përgjegjëse për detyrimet e saj me të gjitha asetet.

Neni 9
Të drejtat e lidhura me cdo kuotë

9.1. Cdo pjesë e secilit ortak do t'i përgjigjet një vote korresponduese në mbledhjet e ortakëve dhe do t'i japë ortakëve të drejtën për të marrë dividendë në rast shpërndarje të fitimit si dhe të drejtën e pjesës përkatëse që mbetet pas procedurave të likuidimit në rast prishje apo likuidimi të Shoqërisë.

Neni 10
Fitimi dhe kalimi i kuotave

10.1. Kuotat e kapitalit te shoqerise fitohen apo kalohen nepermjet:

1. kontributin ne kapitalin e shoqerise;
2. shitblerjes;
3. trashëgimisë,
4. dhurimit,
5. cdo menyrë tjeter parashikuar me ligj.

10.2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata do bëhet me shkrim.

Neni 11

11.1 Ortakët kanë detyrim të paguajnë pjesën e tyre, të marrin pjesë në mbledhjet e asamblesë nëse ftohen në mënyrën e duhur, të mbështesin Shoqërinë në kryerjen e veprimeve të saj si dhe të përbushin vendimet e mbledhjes së ortakëve dhe organeve të tjera të Shoqërisë të cilat janë marrë në mënyrën e duhur brenda qëllimit të organit përkatës.

PJESA IV
ASAMBLEJA E PERGJITHSHME
Neni 12

Të drejtat e asamblesë së per gjithshme

12.1 Asambleja e per gjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë e cila ka të drejtë të marrë vendime në lidhje me të gjitha cështjet e veprimtarisë së saj.

12.2 Asambleja e per gjithshme përbëhet nga të gjithë ortakët.

12.3 Vetëm asambleja e pergjithshme ka të drejtë të vendosë për sa më poshtë:

- (a) ndryshime dhe modifikime të Statutit;
- (b) pranimin e ortakëve të rinj (pas rritjes së kapitalit apo transferimit të kuotave);
- (c) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit dhe/ose cdo lloj pagimi të pjesshëm ose subvencioni të dhënë nga ortakët;
- (d) bashkimin, ndarjen, prishjen dhe cdo lloj transformimi të Shoqërisë;
- (e) blerjen apo disponimin e interesit pjesëmarrës në shoqëri shqiptare apo të huaja;
- (f) hapjen dhe mbylljen e degëve dhe zyra e përfaqësimit;
- (g) pjesetimin dhe anullimin e kuotave;
- (h) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- (i) miratimin e raporteve vjetore dhe bilancit të shoqërise si dhe shpërndarjen e fitimit;
- (j) blerjen, shitjen dhe dhënien peng të pasurive të paluajtshme;
- (k) marrjen me qira, dhënien me qira ose dhënien e cdo të drejtë përdorimin e pasurive të paluajtshme dhe ndërtesave;
- (l) të vendosë për investimet;
- (m) të japë letra me vlerë, të marrë detyrime, të lëshojë garanci ose letra sigurie
- (n) të përcaktojë parimet e përgjithshme të politikave të shoqërisë;
- (o) të caktojë shpërblimet për administratorët, të përfundojë kontratat e punës me administratorët dhe nëpunësit ekzekutivë të shoqërisë;
- (p) të japë alternativa, të drejta të ndarjes së fitimit vjetor, pagesave në natyrë, të drejtat mbi pensionet ose cdo pagesë mbi largimin e drejtoreve, dhe nëpunësve ekzekutivë të shoqërisë;
- (q) të përfundojë marrëveshje konsultimi dhe bashkëpunimi;
- (r) emerimin dhe shkarkimin e likujduesve, ekspertëve kontabël te autorizuar;
- (s) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
- (t) percaktimin e shperblimeve per likujduesit, ekspertet kontabel;
- (u) mbikqyerjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratorët;
- (v) miratimin e rregullave të brendshme mbi administrimin dhe mbledhjes se asamblese;
- (w) përcaktimin e strukturës organizative dhe administrative të Shoqërisë;
- (x) përcaktimin e buxhetit vjetor;

(y) miratimin e cdo cështje tjetër zgjidhja e së cilës i është rezervuar asamblesë së per gjithshme në përputhje me ligjin dhe këtë Statut.

- 12.4 Asambleja e per gjithshme do të ketë të drejtë të vendosë mbi cdo cështje që tejkalon aktivitetin e përditishëm të shoqërisë.

Neni 13 **Vendimet e asamblesë së per gjithshme**

- 13.1 Vendimet e renditura përsa i përket ndryshimit të statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë merren me $\frac{3}{4}$ e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Neni 14 **Thirrja e asamblesë së per gjithshme**

- 14.1 Asambleja e per gjithshme do të thirret nga administratorët të paktën njëherë në vit në selinë e Shoqërisë ose ne cdo vend tjeter nëse percaktohet ne njoftim.
- 14.2 Gjithashtu, ortakët të cilet perfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave ne asamblenë e përgjithshme të shoqërisë mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim ose nëpërmjet postës elektronike për të thirrur asamblenë e per gjithshme. Në kërkesën drejtar administratorëve mund të përfshihen dhe cështjet e posacme të rendit të ditës.
- 14.3 Asambleja e per gjithshme do të thirret me anë të një njoftimi të shkruar të dërguar nga administratorët, njoftim ky i cili duhet të merret nga përfaqësuesit e ortakëve nëpërmjet një letre rekomande, telexi apo faksi jo më pak se 7 (shtatë) ditë përpara datës së caktuar të mbledhjes. Njoftimi i shkruar do të regjistrohet në librin e procesverbalit të shoqërisë. Gjithashtu, asambleja e per gjithshme mund të thirret nëpërmjet postës elektronike me të njëjtat kushte dhe afate.
- 14.4 Njoftimi për takimin e asamblesë së per gjithshme do të tregojë datën kohën dhe vendin e takimit si dhe cështjet e rendit të ditës
- 14.5 Nëse data për mbledhjen e ardhshme të asamblesë është vendosur në takimin e fundit dhe të gjithë ortakët kanë qënë prezentë, atëherë do të gjykohet sikur njoftimi është dërguar.


- 14.6 Nëse të gjithë ortakët janë prezantë në asamblenë e ortakëve, atëherë vendimet mund të merren dhe në mungesë të përmbushjes së kërkesave formale të caktuara më sipër nëse të gjithë ortakët janë dakord.

Neni 15 **Vendimet e marra në asamblenë e per gjithshme**

- 15.1 Vendimet në asamblenë e per gjithshme të cilat kërkojnë një shumicë të zakonshme mund të merren vetëm nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 % të kuotave. Vendimet në asamblesë e përgjithshme të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar mund të merrën vetëm nëse janë të pranishëm ortakët të cilët zoterojnë më shumë së gjysmën e numrit total të votave.
- 15.2 Prokura duhet të jetë e noterizuar dhe të paraqitet në mbledhjen e asamblese. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
- 15.3 Cdo ortak ka të drejtë të thërrasë këshilltarë në mbledhjen e asamblese, të cilat do të janë të detyruar të ruajnë fshehtësinë e mbledhjes.
- 15.4 Nëse mbledhja e asamblese se per gjithshme thirret në mënyrë të rregullt por nuk plotësohet numri i ortakëve të caktuar për të përmbushur kuorumin, atëherë asambleja do të thirret përsëri në përputhje me Nenin 14 dhe gjithmonë jo më vonë se 30 ditë me të njëjtin rend dite.

Neni 16 **Drejtimi i mbledhjes se asamblese se per gjithshme**

- 16.1 Kryetari i mbledhjes së asamblese se per gjithshme do të caktohet nga ortaket.
- 16.2 Do të aprovojen apo refuzohen vetëm ato cështje të cilat janë përcaktuar shprehimisht në rendin e ditës për mbledhjen e asamblese. Diskutimet mbi cështje të ndryshme nga ato të rendit të ditës mund të bëhen vetëm nëse të gjithë ortakët japid pëlqimin e tyre.



Neni 17
Procesverbali i mbledhjes së asamblese se pergjithshme

- 17.1 Për cdo mbledhje të asamblese se pergjithshme do të mbahet një procesverbal dhe do të merren vendime. Prosesverbali duhet të mbajë datën, vedin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit dhe të mbajtësit të procesverbalit dhe rezultatet e votimit. Një kopje e procesverbalit do të përgatitet për Shoqerinë, një për regjistrin tregëtar dhe një për secilin ortak. Prosesverbali i bashkangjitet edhe lista e pjesëmarrësve së bashku me aktin e thirrjes së asamblesë së përgjithshme.
- 17.2 Prosesverbali do të firmoset nga kryetari dhe nga mbajtesi i procesverbalit.
- 17.3 Kopjet e vendimeve përkatëse të ortakëve do t'u dërgohen ortakëve me letër rekomande jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas takimit të ortakëve. Nëse shoqëria ka publikuar një faqe në internet, një kopje e procesverbalit do të publikohet jo më vonë se 15 ditë ng data e mbledhjes në këtë faqe.
- 17.4 Administratori është përgjegjës për ruajtjen e kopjeve të procesverbalist dhe shpërndarjen e tij.

PJESA V
ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Neni 18
Administrimi i Shoqërisë

- 18.1 Administrimi i shoqërisë do të bëhet nga një ose me shume administratore, te cilet do te përfaqësojnë Shoqerinë. Gjithashtu, asambleja e pergjithshme mund të caktojë kompetenca përfaqësimi individuale secilit prej administratorëve.
- 18.2 Administratorët mund të autorizojnë palë të treta që t'i përfaqësojnë ata në transaksione të vecanta.



18.3 Administratorët do të organizojnë dhe menaxhojnë të gjithë aktivitetin e Shoqërisë. Ata janë të autorizuar të përfaqësojnë Shoqërinë në të gjitha cështjet që kanë lidhje me të.

18.4 Të drejtat dhe detyrimet e administratorëve burojnë nga ligji, ky Statut, vendimet e Asamblese se Pergjithshme dhe rregullat e brendshme të administritimit të Shoqërisë.

18.5 Administratorët kanë të drejtat e mëposhtme:

- përfaqësimin e Shoqërisë kundrejt palëve të treta dhe shtetit;
- hapjen e llogarive bankare të Shoqërisë me bankat;
- përfundimin e marrëveshjeve mbi dhënien e huave;
- përfundimin e marrëveshjeve me palët e treta, lëshimin dhe marrjen e urdhër pagesave;
- nënshkrimin e të gjithë dokumentave, nxjerjen e faturave, transferimet në monedhë të huaj, fletë ngarkesat etj, pagimin e detyrimeve të Shoqërisë dhe pranimin e letrave me vlerë nga palët e treta;
- mbledhjen e detyrimeve që i takojnë shoqërisë, dhënien dhe marrien e paradhënieve;
- dhënien e moratoriumit debitorëve të Shoqërisë, heqjen dorë nga paditë që vijnë si pasojë e marrëdhënieve të Shoqërisë me palët e treta dhe/ose pranimin e këtyre padive;
- punësimin dhe shkarkimin e stafit të Shoqërisë, përcaktimin e pagave, shpërblimeve dhe pagesave të stafit;
- marrjen e masave paraprake për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë, fillimin e padive dhe marrjen përsipër të mbrojtjes së Shoqërisë në rast të padive kundër saj; administratorët mund të udhëzojnë avokatët të mbrojnë Shoqërinë dhe mund të përcaktojnë shumën e shpërblimit të tyre; administratorët kanë të drejtë të ngrenë padi dhe t'i térheqin ato, të nënshkruajnë marrëveshje gjyqësore, të myllin marrëveshje arbitrazhi, të caktojnë arbitra, të térheqin paditë e ngritura nga Shoqëria dhe të ndërprejnë procedimet;
- administratorët kanë të drejtë marrin cdo vendim tjetër që i takon aktivitetit të përditshëm të Shoqërisë nga pikëpamja e ligjit dhe këtij Statuti;
- mbledhjen e shpenzimeve të Shoqërisë;
- administratorët janë përgjegjës për mbajtjen e llogarive në përputhje me ligjin dhe parimet e ligjit;



- administratorët janë përgjegjës për përgatitjen dhe nënshkrimin e bilancit vjetor dhe pasqyrave vjetore financiare të Shoqërisë dhe kontrollin e tyre nga një auditor i jashtëm nëse dicka e tillë kërkohet nga ligji apo vendimi i mbledhjes së ortakëve;
- thirrjen e mbledhjeve të ortakëve; përcaktimin e rendit të ditës; monitorimin e përbushjes së dispozitave që kanë lidhje me thirrjen dhe drejtimin e mbledhjes së ortakëve për shpalljen e vendimeve të vecanta;
- publikimin e shpalljeve të nevojshme përfshirë dhe publikimin e pasqyrave vjetore financiare;
- administratorët janë përgjegjës për mbajtjen e rregullt dhe ruajtjen e dokumentacionit të Shoqërisë;
- marrin vendime mbi të gjitha cështjet e tjera që lidhen me aktivitetin e brendshëm të Shoqërisë dhe marrëdhëniet e saj të jashtme.

18.6 Personi e mëposhtëm do të caktohet administrator për një periudhë 5 (pesë) vjecare me të drejtë ripërtëritjeje:

1.ELTON SOTA, i lindur më 08.01.1981 ne Fier ,i identifikuar me karte identiteti me numër personal I10108015H, madhor me zotësi të plotë për të vepruar

PJESA VI
VITI FINANCIAR, BILANCI, FITIMI DHE HUMBJET
Neni 19

Viti finanziar, pasqyrat vjetore financiare

19.1 Viti finanziar i Shoqërisë zgjat 12 muaj dhe fillon në ditën e parë të Janarit dhe mbaron në ditën e tridhjetë e një të Dhjetorit. Viti i parë finanziar i Shoqërisë fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë dhe mbaron në datën e tridhjetë e një-të të Dhjetorit.

19.2 Në fund të cdo viti finanziar, administratorët do të përbushin detyrat e mëposhtme:

- përgatitjen e një liste të detajuar të aseteve të Shoqërisë dhe strukturës së tyre;
- përgatitjen e bilancit të shoqërisë i cili përshkruan situatën financiare të Shoqërisë;

- (c) përgatitjen e llogarive të fitimit dhe të humbjeve.
- 19.3 Pasqyrat financiare të përgatitura do të paraqiten në mbledhjen e zakonshme të asamblesë së ortakëve së bashku me një raport të auditorëve të jashtëm për miratim.

Neni 20
Fitimi i Shoqërie

Fitimi neto i Shoqërisë do të shpërndahet në përputhje me pjesët e kapitalit në Shoqëri..

Fitimi neto do të jetë fitimi i Shoqërisë në përputhje me pasqyrat vjetore financiare të miratuara pas zbritjes së të gjitha taksave dhe caktimit të rezervave ligjore. Bilanci i shoqërisë do të miratohet nga asambleja e otakëve dhe do të dorëzohet në organet tatimore përpara fundit të muajit Mars të vitit pasardhës.

PJESA VII
PRISHJA DHE LIKUIDIMI

Neni 21
Prishja dhe likuidimi

- 21.1 Shoqëria do të zgjidhet në rastet e mëposhtme:
- (a) vendim i mbledhjes së asamblesë së ortakëve;
 - (b) bashkimi me një shoqëri tjeter;
 - (c) vendimi i gjykatës me juridikcion përkatës në rastet e parashikuara me ligj;
 - (d) në të gjitha rastet e tjera të parashikuara me ligj.
- 21.2 Likuidimi i Shoqërisë dhe shpërndarja e aseteve të Shoqërisë do të bëhet në përputhje me dispozitat ligjore.

PJESA VIII
TE PERGJITHSHME

Neni 22
Te pergjithshme

- 22.1 Në rast mosmarrëveshjes të cilat lindin si pasojë e këtij Statuti ose për shkak të ligjit, ortakët do të përpilen t'i zgjidhin ato miqësisht. Nëse nuk arrihet një marrëveshje, mosmarrëveshja e ortakëve do të zgjidhet nga gjykata me juridikcion përkatës.
- 
- 

22.2 Ligji zbatues është ligji shqiptar.

22.3. Ky statut hartohet dhe nënshkruhet në 2(dy) kopje originale.

ORTAKET

ELTON SOTA

Elton Sota

ZAMIRA RUBJEKA

Zamira Rubjeka